



Pranuar / Dorezuar Prenjshëm/Prodato Received/Delivered	14-10-2022	2 viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTK	6231/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.581/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti –kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1879/2021, të datës 04.10.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.581/2021 të datës 22.06.2021 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit, Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike “transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.581/2021 të datës 22.06.2021, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Gjakovës në pozitën “Udhëheqëse e Sektorit për Gjendje Civile” sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër 01-112/02-10859 të datës 18.03.2019, më datë 22.06.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3254/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës me numër 01Nr.112/02-15799 të datës 18.06.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.06.2021, me numër protokoll 3329/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa me datë 08.07.2021 me numër protokoll 3569/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, me shkresën me numër protokoll 4118/2021 të datës 06.08.2021 ka udhëzuar ankuesen për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me datë 16.09.2022 ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.1879/2021, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 04.10.2022 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.08.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 22.06.2021.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me nr. protokoll 3254/2021 të datës 22.06.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore me numër 01Nr.112/02-15799 i datës 18.06.2021; Vendim nga Kryetari i Komunës së Gjakovës me numër 01Nr.112/02-34497 i datës 10.09.2019; Aktgjykim A.nr.1879/2021 i datës 16.09.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 04.10.2022 me numër protokoll 5849/2022; Fletëkthesë e datës 12.08.2021; Njoftim me numër protokoll 4118/2021 i datës 06.08.2021; Pliko me numër R1626989 e datës 18.06.2021; Fletëkthesë e datës 05.07.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.06.2021; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 3569/2021 e datës 08.07.2021; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit i T.V. me numër 01-112/02-10859 i datës 18.03.2019; E-mail nga D.T. për K.B. i datës 18.06.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i T.V. i datës 29.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i T.V. i datës 18.01.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i T.V. i datës 22.12.2015; Pliko me numër R1700659 i datës 06.07.2021; E-mail nga K.B. për C.Z. i datës 10.10.2022; E-mail nga C.Z. për K.B. i datës 10.10.2022; Vendim nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore me Nr.01-112/02-021 i datës 05.01.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave; pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses, është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar Vendimin me numër 01Nr.112/02-15799 të datës 18.06.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës lidhur me transferin e përkohshëm të ankueses në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit për Shërbime Sociale" nga pozita "Udhëheqëse e Sektorit për Gjendje Civile, duke pasur parasysh se sipas këtij vendimi tashmë ankueses i ka përfunduar periudha e transferimit më datë 04/01/2022, me qëllim të konstatimit të saktë të këtij elementi përmbajtësor të kësaj ankese respektivisht pretendimi me datën 10.10.2022 përmes e-mailit zyrtar Këshilli ka kërkuar



informata zyrtare prej Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës lidhur me atë se: "A është rikthyer në vendin e mëparshëm të punës ankuesja sipas vendimit me numër 01Nr.112/02-15799 të datës 18.06.2021 në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit për Gjendje Civile" ndërsa në përgjigjen zyrtare të datës 10.10.2022 përmes e-mailit zyrtar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore adresuar Këshillit e cila shkresë është protokolluar me numër 6064 datë 11.10.2022, Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës ka deklaruar se: "Përmes vendimit me numër Nr. 01-112/02-021 të datës 05.01.2022 nëpunësja civile Teuta Vokshi është rikthyer në vendin paraprak të punës". Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në këtë shkresë zyrtare të organit të punësimit konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës se ankueses tashmë është bërë i pamundur ose i kotë, pasi që ankuesja me vendimin numër Nr. 01-112/02-021 të datës 05.01.2022 është rikthyer në vendin e punës në pozitën e mëparshme "Udhëheqëse e Sektorit për Gjendje Civile" në kuadër të Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative në Komunë të Gjakovës, e krejt kjo në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë".

Duke marrë për bazë këto rrethana të potencuara si më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.581/2021, datë 14/10/2022.

Çlirim Zeka

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

